

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Miley Cyrus zbulon bisedën e fundit me Dolly Parton! "Ajo ishte gjithmonë..." Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/miley-cyrus-zbulon-biseden-e-fundit-me-dolly-parton-ajo-ishte-gjithmone/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:50:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:38:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8cb1d8e94beb5657521c6208f7c47c9e1f02b9905e53d06746bc2d39121a1c4
TEKSTI	fa9a11910b540ce797087065470c5171fee7970ab2b5becce70fb1080b74ca68
PAMJA	2c6e293c4f99fe5e2e4d02594a78a7c5a0f315e5b8d7d53ce639472221d56b10

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ae008987ca3d8df178812eab836f7878411b83b8f256c21ae985d19c566ffacb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ae008987ca3d8df178812eab836f7878411b83b8f256c21ae985d19c566ffacb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Miley Cyrus zbulon bisedën e fundit me Dolly Parton! “Ajo ishte gjithmonë...”



Redaksia K

18 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Miley Cyrus ka rrëfyer për herë të parë me më shumë detaje se çfarë diskutoi me Dolly Parton në bisedën e tyre të fundit, pak para se legjenda e muzikës country të ndahej nga jeta.

Në një intervistë me Zane Lowe për Apple Music, **Cyrus** tregoi se biseda e fundit me të ashtuquajturën “nënë shpirtërore” të saj ishte pikërisht për muzikën dhe albumin e ri të këngëtares, “Bass Persuades”.

Miley tregoi se Parton kishte qenë prej vitesh personi i parë të cilit ajo i dërgonte një kopje vinyl të albumeve të saj. Edhe këtë herë kishte planifikuar t’ia dërgonte albumin e ri, por nuk pati mundësinë ta bënte.



Herën e fundit që folëm, në fakt po i tregoja për këtë album

-rrëfeu Cyrus, duke shtuar se dallimet mes tyre ishin pikërisht ajo që e bënte marrëdhënien e tyre kaq të veçantë.

Sipas Miley-t, **Dolly** kishte një imazh shumë të dallueshëm publik flokë të mëdhenj, grim, veshje spektakolare dhe një prezencë të fuqishme skenike, por pas gjithë kësaj fshihej një person jashtëzakonisht autentik.



Ajo njihet për flokët, grimin dhe spektaklin, por ekziston një pjesë e saj që njerëzit e duan më shumë, sa reale dhe autentike është

-tha këngëtarja.

Miley tregoi gjithashtu se Dolly kishte luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën se si ajo e kuptoi marrëdhënien mes personazhit publik dhe vetes së saj të vërtetë.

Gjatë viteve të saj si Hannah Montana, Miley ishte mësuar të jetonte mes dy identiteteve, vajzës që shfaqej në televizion dhe personit që ishte larg kamerave. Sipas saj, Dolly e ndihmoi të kuptonte se mund të kesh një “personazh” publik dhe njëkohësisht të mbetesh besnike ndaj vetes.

“

Mund të kesh një personazh dhe përsëri të jesh ajo që je, sepse unë kisha Dolly-n

-shpjegoi Cyrus.

Por një nga kujtimet më prekëse lidhet me emocionet e Miley-t gjatë performancave. Ajo tregoi se shpesh qan në skenë dhe se Dolly dikur e kishte pyetur pse qante gjatë këngëve.

Dolly i kishte dhënë një këshillë shumë të thjeshtë:

“

Muzika është arratisje. Lëri të qajnë. Duhet ta përfundosh.

Miley, megjithatë, i ishte përgjigjur se nuk mund ta ndryshonte këtë pjesë të vetes, dhe Dolly e kishte pranuar pikërisht për këtë arsye.

Cyrus kujtoi gjithashtu momentin kur të dyja performuan së bashku “I Will Always Love You”. Për Miley-n, ajo performancë kishte një domethënie më të thellë, pasi ajo e dinte se një ditë njerëzit e brezave para saj nuk do të ishin më aty për t'i kërkuar këshilla.

“

Ata kanë ndërtuar, tullë pas tulle, rrugën nëpër të cilën unë po ec tani. Dhe nuk do të jenë gjithmonë aty që t'i telefonoj e t'i pyes: 'Çfarë të bëj tani?', gjë që e bëja gjithmonë me Dolly-n

-tha ajo.

Dhe pikërisht këtu erdhi një nga deklaratat më emocionale të Miley-t për të.

“

Ajo ishte gjithmonë e drejtë

-tha Cyrus, duke e krahasuar Dolly-n me një nënë që, edhe kur je fëmijë dhe mendon se ajo nuk di asgjë, me kalimin e viteve kupton se këshillat e saj ishin të sakta.

Dolly Parton, e cila ishte 80 vjeçe, u nda nga jeta më 25 gusht 2026 pas një beteje të shkurtër me kancerin. Pas vdekjes së saj, Miley e përshëndeti publikisht “Aunt Dolly”, duke shkruar se momentet më të shenjta mes tyre do të mbeteshin private. Ajo zbuloi gjithashtu se një nga bisedat e fundit mes tyre kishte qenë për muzikën dhe metamorfozën.

Për Miley Cyrus, humbja e Dolly-t nuk nënkupton vetëm largimin e një ikone të muzikës, por edhe të një prej njerëzve që e kishte udhëzuar në disa prej momenteve më të rëndësishme të jetës së saj. Dhe tani, këshillat e saj mbeten si një zë që Miley do ta mbajë me vete në rrugën që vazhdon.

LAJME TË NGJASHME



Motra e Dolly Parton rrëfen ditët e fundit të këngëtares: “E dija se ishte në paqe”



Llogaritë e Dolly Parton publikojnë një mesazh prekës dy javë pas vdekjes së saj!

2.5 MIN



Motra e Dolly Parton reagon ndaj komenteve pas vdekjes së saj!

1 MIN

1 MIN



Miley Cyrus tërheq vëmendjen me videoklipin e ri? Pse?

1.5 MIN



Ylli i Dolly Parton në "Hollywood Walk of Fame" dëmtohet, nis puna për zëvendësimin e tij!

2.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundra plakjes?



"E dashura jote duhet të shkojë me dikë tjetër"/ Avokat Ngjela zbulon kurën për ...



"Nuk mund ta lija jetim"/ Pse nuk u bë kurrë baba? Spartak Ngjela rrëfhet: Më mirë mos prano të bësh fëmijë, sesa...



Greta Kazazi zbulon si është sot raporti me Selin dhe planet për të ardhmen!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Majko përlohet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi gjyqës: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte

EDITORI SUGJERON




Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundra plakjes?




Red Light Therapy, çfarë tregojnë studimet për terapinë me dritë të kuqe dhe rindërtimin e



Më shumë vite, më shumë shëndet: 7 zakone që mund t'i ndihëjnë në luftën me



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..."/ Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam



"Të kisha çerekun e egove të kolegeve të mia..."/ Çiljeta Xhilaga: Nuk kam asnjë plan për

shenjat që tregojnë se ushqimi

duhet të hidhet para se të...



10 shenjat që tregojnë se ushqimi
duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut
është më i mirë për sheqerin në
gjak dhe kaliumin...

10 pjesët më të mira të mishit të



10 pjesët më të mira të mishit të
viçit për proteina me pak yndyrë!

Pilula eksperimentale imiton
hormonin që prodhohet gjatë



Pilula eksperimentale imiton
hormonin që prodhohet gjatë
aktivitetit fizik intensiv!

Çfarë nuk duhet të mungojë në
dietën tuaj për flokë të



Çfarë nuk duhet të mungojë në
dietën tuaj për flokë të
shëndetshëm...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informative dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.